



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/309

17.07.2023

Podujevë

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaze dhe institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), për vitin shkollor 2023-2024 (MASH), referencë 3-12847, dt. 14/07/2023, Drejtoria e Arsimit në Podujevë shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË GJIMNAZE DHE NË INSTITUCONET E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024

I. Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani” Podujevë

Nr.	Drejtimi - Profili arsimor	Nr. i paraleleve
1.	Shkenca shoqërore – gjuhësore	8 x 26
2.	Shkenca natyrore	8 x 26
3.	Shkenca shoqërore - gjuhësore paralelja e ndarë në Orllan	1 x 26
Gjithsej 17 paralele me 442 nxënës		

II. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional IAAP “Isa Boletini” Podujevë

Nr.	Fusha	Nr. i paraleleve	Gjithsej nxënës	Vitet shkollimit e
1.	Drejtimi: Ekonomi, administrim dhe juridik – Profilet:			
a.	Kontabilist	3 x 22	66	2+1
b.	Banka dhe sigurime	3 x 22	66	2+1
c.	Marketing	3 x 22	66	2+1
d.	Shpedicion dhe logjistikë	3 x 22	66	2+1
e.	Administrim i zyrës	3 x 22	66	2+1
f.	Asistent i administratës	3 x 22	66	2+1
2.	Drejtimi: Agrokulturë – Profilet:			
a.	Agrobiznes	1 x 22	22	2+1
3.	Drejtimi: Shëndeti dhe mirëqenia – Profilet:	Nr. i paraleleve		
a.	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	1 x 26	26	2+1
b.	Teknik i farmacisë	1 x 26	26	2+1
Gjithsej 21 paralele me 470 nxënës				

III. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional IAAP “Fan S. Noli” Podujevë

Nr.	Fusha	Nr. paraleleve	Gjithsej nxënës	Vitet shkollimit
1.	Drejtimi: Teknologji e informacionit dhe komunikimit – Profilet:			
a.	Zhvillues i aplikacioneve softverike	1 x 22	22	2+1
b.	Teknik i sistemeve të TIK	1 x 22	22	2+1
c.	Informatikë	1 x 22	22	2+1
d.	Teknik i informatikës së biznesit	1 x 22	22	2+1
e.	Telekomunikacion	1 x 22	22	2+1
f.	Energjetikë	1 x 22	22	2+1
g.	Instalues elektrik	1 x 22	22	2+1
2.	Drejtimi: Makineri, prodhim dhe ndërtimtari – Profilet:			
a.	Automekanik	2 x 22	44	2+1
b.	Instalimi ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	2 x 22	44	2+1
c.	Trafik rrugor	1 x 22	22	2+1
d.	Transport rrugor	1 x 22	22	2+1
e.	Arkitekturë	1 x 22	22	2+1
Gjithsej 14 paralele me 308 nxënës				

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10), në gjimnaze dhe në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), për vitin shkollor 2023/2024, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e IX- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e dhjetë (10) në gjimnaze dhe institucione të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- ❖ **Fletëparaqitjen** (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- ❖ **Dëftesën origjinale** për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- ❖ **Certifikatën e lindjes.**

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve në gjimnaze dhe institucione të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) për vitin shkollor 2023/2024, bëhet më datë **18, 19, 20 korrik 2023** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8:00-16:00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse më datë **21.07.2023**.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **24 korrik 2023**.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesa në shkallën e dytë bëhet në Drejtorinë Komunale të Arsimit, brenda dy (2) ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e dhjetë (10) duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi mund t'i fitojë maksimalisht (100%) 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat 6-9, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6, 7, 8, 9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl. 6 + kl. 7 + kl. 8 + kl. 9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max.}$$

Nxënësi nga suksesi i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

$$\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max.}$$

❖ **Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:**

- a. **Gjimnazi i shkencave natyrore:** Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë
- b. **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore:** Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi

❖ **Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP:**

- a. **Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari:** Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
- b. **Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi – Teknologji, PTT:** Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi,
- c. **Juridik dhe administratë:** Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi
- d. **Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:** Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare, Gjeografi
- e. **Ekonomi, administratë:** Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi
- f. **Shkollat artistike:** Gjuhë amtare dhe letërsi, Edukatë qytetare, Art, Muzikë

Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar.

Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VII), në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VI).

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

4. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Biologji) + mes(Fizikë) + mes(Matematikë)}{4} \geq 4$$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët histori, gjeografi)

$$\frac{mes.gj.amtare + mes.gj.ang. + mes.his + mes.gjeo.}{4} \geq 4$$

- **Shkolla e shëndetësisë** - Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Biologji) + mes(Fizikë) + mes(Gjuhë_shqipe)}{4} \geq 4$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze

1. Gjuhë shqipe 35 pikë
 2. Gjuhë angleze 15 pikë
- (Gjithsej 50 pikë)

II. Shkencat shoqërore:

1. Gjeografi 25 pikë
 2. Histori 25 pikë
- (Gjithsej 50 pikë)

III. Matematikë dhe Informatikë

1. Matematikë 35 pikë
 2. Informatikë 15 pikë
- (Gjithsej 50 pikë)

IV. Shkencat natyrore:

1. Fizikë 17 pikë
 2. Kimi 16 pikë
 3. Biologji 17 pikë
- (Gjithsej 50 pikë)

5. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

- | | | |
|-----------------------------------|----|-----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës | 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe Informatikë | 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

II. Gjimnazi shoqëror dhe gjuhësor:

- | | | |
|-----------------------------------|----|-----------------------------|
| 1. Shkenca shoqërore | 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë | 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore | 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

6. Renditja e lëndëve me prioritate sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | | |
|-----------------------------------|----|-----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës | 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë | 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

- | | | |
|-----------------------------------|----|-----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë | 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Shkencat e natyrës | 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

III. Ekonomi

- | | | |
|-----------------------------------|----|-----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë | 50 | $50 \times 0.4 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 50 | $50 \times 0.2 = 10$ pikë |
| 3. Shkencat shoqërore | 50 | $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat e natyrës | 50 | $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë |

Totali = 40 pikë

IV. Juridik

- | | |
|-----------------------------------|----|
| 1. Shkencat shoqërore | 50 |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 50 |
| 3. Matematikë dhe Informatikë | 50 |
| 4. Shkencat e natyrës | 50 |

$50 \times 0.4 = 20$ pikë
 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- | | |
|-----------------------------------|----|
| 1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 50 |
| 2. Shkenca shoqërore | 50 |
| 3. Matematikë dhe Informatikë | 50 |
| 4. Shkencat e natyrës | 50 |

$50 \times 0.4 = 20$ pikë
 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

Drejtori
Avni Fetahu

